



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 26.09.2017

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR DEKRETIN NR. 9769, DATË 18.10.2016, TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR “KTHIMIN E LIGJIT NR. 93/2016 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9640, DATË 9.11.2006, “PËR DHOMAT E TREGTISË DHE INDUSTRIË”, TË NDRYSHUAR”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi dekretin nr. 9769, datë 18.10.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, “Për kthimin e ligjit nr 93/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9640, datë 9.11.2006 “Për dhomat e tregtisë dhe industrisë”, në mbledhjen e datës 26 Shtator 2017.

Në arsyet e kthimit të ligjit, Presidenti i Republikës ka paraqitur dhe argumentet me të cilat arsyeton kthimin për rishqyrtim të tij, të cilat lidhen me:

- Kushtetueshmërinë e rregullimit ligjor në lidhje me detyrueshmërinë e anëtarësimit në Dhomat e Tregtisë dhe Dhomat e Bashkuara të Tregtisë.

Në argumentet e paraqitura Presidenti argumenton se vendosja e detyrimit për anëtarësi në Dhomën e Tregtisë dhe industrisë përbën një shkelje kushtetuese referuar nenit 46 të Kushtetutës dhe krijon premisat për vendosjen e një takse të fshehtë për biznesin nëpërmjet pagesës së kuotës së anëtarësisë në dhomat e tregtisë nga të gjithë personat fizikë dhe juridikë.

- Mungesën e qartësisë lidhur me llojin dhe cilësinë e shërbimeve që DHTI dhe BDHTI do të ofrojnë për anëtarët që do të anëtarësohen në mënyrë të detyrueshme.
- Mungesën e rregullimeve ligjore të cilat garantojnë transparencë në administrimin e të ardhurave të krijuara nga pagesat e kuotave në rastin e dhomave të tregtisë.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë Dekret sipas përcaktimeve të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit, i cili në pikën 2 përcakton se Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës.

Dekreti i Presidentit nuk i referohet neneve të veçanta të ligjit, por shprehet në parim për të. Për këtë arsye Komisioni do të shprehet në parim për dekretin e Presidentit, pa bërë ndryshime të neneve të veçanta.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm, vendosi t'i rekomandojë seancës plenare **miratimin e dekretit** të Presidentit të Republikës, nr. 9769, datë 18.10.2016 “Për kthimin e ligjit nr. 93/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9640, datë 9.11.2006, “Për dhomat e Tregtisë dhe Industrisë”, të ndryshuar””.

RELATOR

KRYETAR

Eduard SHALSI

Eduard SHALSI